



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 04/2016 PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE
MENAXHIMIN E PROGRAMIT TË RIINTEGRIMIT¹**

**REGULATION (GRK) NO. 04/2016 ON REINTEGRATION OF REPATRIATED PERSONS AND
MANAGEMENT OF THE REINTEGRATION PROGRAM²**

**UREDBA (VRK) BR. 04/2016 ZA REINTEGRACIJU VRAĆENIH OSOBA I ZA UPRAVLJANJE
PROGRAMOM ZA REINTEGRACIJU³**

¹ Rregullore (QRK) nr. 04/2016 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit, është miratuar në mbledhjen e 78 të Qeverisë së Kosovës, me vendimin nr. 04/78, të dates 09.03.2016.

² Regulation (grk) no. 04/2016 on reintegration of repatriated persons and management of the reintegration program, was approved on the 78 meeting of the Government of Kosovo, with the decision no. 04/78, date 09.03.2016.

³ Uredba (vrk) br. 04/2016 za reintegraciju vraćenih osoba i za upravljanje programom za reintegraciju, usvojen je na 78 sednice Vlade Kosova, odlukom br. 04/78, datum 09.03.2016.

<p>Qeveria e Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4 të Rregullores për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive nr.02/2011 (GZ,nr.1 22.03.2011), si dhe në nenin 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë nr.09/2011, (GZ nr. 15 / 12.09.2011),</p> <p>Miratton:</p> <p>RREGULLORE QRK - NR. 04/2016 PËR RIINTEGRIMIN E PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE MENAXHIMIN E PROGRAMIT TË RIINTEGRIMIT</p> <p>KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p> <p>Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i kësaj Rregulloreje është që të ndihmojë dhe të mbështesë riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë, gjithashtu mbështet zbatimin e</p>	<p>Government of Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to article 93 (4) of the Constitution of the Republic of Kosovo, pursuant to article 4 of Regulation for the areas of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries No. 02/2011 (OG, no.1 22/03/2011), and based on the article 19 (6.2) of the Rules of Procedure of the Government No. 09/2011, (OG no. 15 / 12.09.2011),</p> <p>Approves:</p> <p>REGULATION GRK – NO. 04/2016 ON REINTEGRATION OF REPATRIATED PERSONS AND MANAGEMENT OF THE REINTEGRATION PROGRAM</p> <p>CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p>Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this Regulation is to facilitate and support the sustainable reintegration of repatriated persons to Kosovo, it is also to support the</p>	<p>Vlada Republike Kosovo,</p> <p>Na osnovu člana 93 (4) Ustava Republike Kosova, člana 4 Uredbe za oblasti Administrativnih odgovornosti, ureda premijera i ministarstava br. 02/2011 (SL br.1 22.03.2011) i na osnovu člana 19 (6.2) Poslovnika o radu Republike Kosovo nr.09/2011, (SL br.15 /12. 09.2011.),</p> <p>Usvaja:</p> <p>UREDBA VRK - BR. 04/2016 ZA REINTEGRACIJU VRAĆENIH OSOBA I ZA UPRAVLJANJE PROGRAMOM ZA REINTEGRACIJU</p> <p>POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p>Član 1 Cilj uredbe</p> <p>Cilj uredbe je da pomogne i podrži stalnu reintegraciju povratnika na Kosovu, takođ implementaciju reintegracije vraćenih osoba, odobrena od vlade, da definiše</p>
--	--	--

<p>Strategjisë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, definojnë organet kompetente vendimmarrëse, zbatuese dhe koordinuese, procedurat dhe kriteret për përfitimet dhe ndihmën për riintegrim.</p>	<p>implementation of the Strategy for Reintegration of Repatriated persons, and to define the competent decision making, implementing and coordinating bodies, procedure and criteria for benefits and assistance for reintegration.</p>	<p>kompetentne organe za donošenje odluka, koji mogu biti izvršni i koordinirajući, postupci i kriterijumi za beneficije i podršku za reintegraciju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p>
<p>Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen nga të gjitha organet kompetente në procesin e riintegrimit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.</p>	<p>The provisions of this regulation shall be implemented by all competent bodies in the process of reintegration in exercising of their function.</p>	<p>Odredbe ove uredbe važe za sve nadležne organe u procesu reintegracije u vršenju njihovih funkcije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicij</p>
<p>1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:</p>	<p>1. Terms and abbreviations used in this Regulation have the following meaning:</p>	<p>1. Uslovi i skracenice koriscene u ovoj Uredbi imaju ovaj smisao:</p>
<p>1.1. Person i riatdhesuar - nënkupton një kosovar të ripranuar në Republikën e Kosovës pa marrë parasysh mënyrën e riatdhesimit;</p>	<p>1.1. Repatriated person - means a repatriated Kosovar readmitted in the Republic of Kosovo regardless of the form of repatriation;</p>	<p>1.1. Vraćeno lice – podrazumeva građanin Kosova repatiran u Republici Kosova bez obzira na način repatrijacije;</p>
<p>1.2. Riintegrimi - nënkupton ripërfshirjen e personave të riatdhesuar në shoqërinë e Kosovës dhe promovimin e kushteve të tyre ekonomike, sociale dhe politike;</p>	<p>1.2. Reintegration - means the re-inclusion of repatriated persons into the society of Kosovo and promoting of economic, social and political conditions;</p>	<p>1.2. Reintegracija - podrazumeva ponovno uključivanje povratnih lica na kosovskom društvu i promovisanje njihovih ekonomskih, socijalnih i političkih uslova;</p>
<p>1.3. Programi - është Programi për</p>	<p>1.3. Program - is the Program for</p>	<p>1.3. Program - je program za</p>

<p>Riintegrim i personave të riatdhesuar i themeluar nga Qeveria;</p> <p>1.4. Përfitimet- nënkuptojnë masat për mbështetjen nga Programi i Riintegrit;</p> <p>1.5. Ndihma - nënkupton shërbimet për mbështetjen e personave të riatdhesuar gjatë procesit të riintegrit dhe promovimin e riintegrit;</p> <p>1.6. Personat e cenueshëm - nënkupton personat e riatdhesuar të cilët kanë nevojë për masa të veçanta të riintegrit si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, apo si pasojë e gjendjes së tyre familjare, apo të moshës;</p> <p>1.7. Menaxhimi në nivelin qendror - nënkupton veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR);</p> <p>1.8. Menaxhimi në nivelin lokal - nënkupton veprimet e ndërmarra nga kryetarët e komunave, Zyrat Komunale për Kthim dhe Komunitete (ZKKK) dhe koordinatorët rajonalë;</p>	<p>Reintegration of Repatriated Persons established by the Government;</p> <p>1.4. Benefits - mean measures for supporting by the reintegration program;</p> <p>1.5. Assistance - means services for supporting the repatriated persons during the reintegration process and reintegration promotion;</p> <p>1.6. Vulnerable persons - mean repatriated persons in need of special reintegration measures as the consequence of their reduced functional capacity resulting from illness or disability or as the consequence of their family situation or age.</p> <p>1.7. Management on the central level - means actions taken by the Ministry for Internal Affairs (MIA) and its Department for Reintegration of Repatriated Persons (DRRP);</p> <p>1.8. Management on the local level - means actions taken by the Mayors, Municipal Offices for Return and Communities (MORC) and the Regional Coordinators;</p>	<p>reintegraciju vraćenih osoba koji je utvrđen od Vlade.</p> <p>1.4. Naknade - su mere za podršku programa reintegracije;</p> <p>1.5. Pomaganje - podrazumeva službe podrške vraćenih lica tokom procesa ponovnog reintegrisanja i promociju reintegrisanja;</p> <p>1.6. Ugrožena lica - podrazumeva vraćena lica kojima je potrebna posebna mera reintegracije, kao posledica njihovog smanjenog funkcionalnog kapaciteta zbog bolesti ili invaliditeta, ili zbog njihovog porodičnog statusa, pola, starosti;</p> <p>1.7. Upravljanje u centralnom nivou - podrazumeva radnje Ministarstva unutrašnjih poslova (MUP) i Odeljenje za reintegraciju vraćenih osoba (ORVO);</p> <p>1.8. Upravljanje na lokalnom nivou - podrazumevaju aktivnosti preduzele od gradonačelnike, Opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak (DMC) i Regionalne Koordinate;</p>
---	--	---

<p>1.9. Komisioni Qendror për Riintegrim - është organi vendimmarrës i cili përbëhet nga përfaqësuesit e ministrive relevante;</p> <p>1.10. Komisioni Komunal për Riintegrim - është organi vendimmarrës i cili përbëhet nga përfaqësuesit e shërbimeve komunale relevante;</p> <p>1.11. Komisioni për Ankesa - nënkupton organin tek i cili mund të parashtrohet ankesa e parë kundër vendimit të lëshuar nga KQR ose KKR të referuar në këtë Rregullore;</p> <p>1.12. Sistemi për Menaxhimin e Rasteve - është sistem elektronik ku procedohen, ruhen dhe arkivohen informatat për personat e riatdhesuar dhe përfitimet e tyre;</p> <p>1.13. Koordinimi - nënkupton që ministrinë përkatëse, autoritetet komunale dhe akterët e tjerë e mbështesin riintegrimin në mënyrë efektive bashkë si tërësi.</p> <p>1.14. DRPR - Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar;</p> <p>1.15. KA - Komisioni për Ankesa;</p>	<p>1.9. Central Commission for Reintegration - is a decision-making body consisting of representatives of relevant ministries;</p> <p>1.10. Municipal Commission for Reintegration - is a decision-making body consisting of representatives of relevant municipal services;</p> <p>1.11. Commission for Appeals - means the body to which a first appeal against a decision made by the CCR or MCR, and referred to in this regulation, may be lodged;</p> <p>1.12. Case Management System - means the electronic system where information on repatriated persons and their benefits is processed, stored and archived;</p> <p>1.13. Coordination - shall mean that the respective ministries and other authorities and actors shall support the reintegration effectively together as a whole.</p> <p>1.14. DRRP - Department for Reintegration of Repatriated Persons;</p> <p>1.15. CA - Commission for Appeal;</p>	<p>1.9. Centralna komisija za reintegraciju - je telo za donošenje odluka sastavljeno od predstavnika relevantnih ministarstava;</p> <p>1.10. Opštinska komisija za reintegraciju - je telo za donošenje odluka sastavljeno od predstavnika relevantnih službi;</p> <p>1.11. Komisija za žalbe - je organ kojem se može izjaviti žalba protiv odluke koju CKR ili OKR iz ove uredbe;</p> <p>1.12. Sistem za upravljanje predmetima - je elektronski sistem koji obrađuje, čuva i arhivira informacije o readmisiranim licima i njihovim prednostima;</p> <p>1.13. Koordinacija - znači da nadležna ministarstva, organi i drugi akteri podrže reintegraciju efikasno zajedno kao celina.</p> <p>1.14. DRVO - Departament za reintegraciju vracenih osoba;</p> <p>1.15. KZ - Komisija za žalbe;</p>
--	---	---

<p>1.16. KKR - Komisioni Komunal për Riintegrim;</p> <p>1.17. KQR - Komisioni Qendror për Riintegrim;</p> <p>1.18. LEB - Lista Esenciale e Barnave;</p> <p>1.19. MAPL - Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal;</p> <p>1.20. MASHT - Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë;</p> <p>1.21. MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;</p> <p>1.22. MeD - Ministria e Diasporës;</p> <p>1.23. MF- Ministria e Financave;</p> <p>1.24. MKK-Ministria për Kthim dhe Komunitete;</p> <p>1.25. MMPH - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;</p> <p>1.26. MPB - Ministria e Punëve të Brendshme;</p> <p>1.27. MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;</p>	<p>1.16. MCR - Municipal Commission for Reintegration;</p> <p>1.17. CCR - Central Commission for Reintegration;</p> <p>1.18. LED - List of Essential Drugs;</p> <p>1.19. MLGA - Ministry of Local Government Administration;</p> <p>1.20. MEST - Ministry of Education Science and Technology;</p> <p>1.21. MAFRD - Ministry of Agriculture Forestry and Rural Development;</p> <p>1.22. MD - Ministry of Diaspora;</p> <p>1.23. MF- Ministry of Finance;</p> <p>1.24. MRC- Ministry of Return and Community;</p> <p>1.25. MESP - Ministry of Environment and Spatial Planning;</p> <p>1.26. MIA - Ministry of Internal Affairs;</p> <p>1.27. MLSW - Ministry of Labour and Social Welfare;</p>	<p>1.16. OKR - Opstinska Komisija za Reintegraciju;</p> <p>1.17. CKR - Centralna Komisija za Reintegraciju;</p> <p>1.18. OSL - Osnovni Spisak Lekova;</p> <p>1.19. MAPL - Ministarstvo za Administraciju Lokalne Vlade;</p> <p>1.20. MONT - Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju;</p> <p>1.21. MPŠRR - Ministarstvo Poljoprivrede, šumarstva i Ruralnog Razvoja;</p> <p>1.22. MD - Ministarstvo za Dijasporu;</p> <p>1.23. MF- Ministarstvo za Finanse;</p> <p>1.24. MPZ - Ministarstvo za Povratak i Zajednice;</p> <p>1.25. MŽSPP - Ministarstvo životne Sredine i Prostornog Planiranja;</p> <p>1.26. MUP - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova;</p> <p>1.27. MRSZ - Ministarstvo Rada i Socialne Zaštite;</p>
--	---	--

<p>1.28. MSH - Ministria e Shëndetësisë;</p> <p>1.29. MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;</p> <p>1.30. MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik;</p> <p>1.31. OJQ - Organizata Jo-Qeveritare;</p> <p>1.32. ON - Organizatat Ndërkombëtare;</p> <p>1.33. PSO - Procedurat Standarde të Operimit;</p> <p>1.34. QAP - Qendrat e Aftësimit Profesional;</p> <p>1.35. SMR - Sistemi për Menaxhimin e Rasteve;</p> <p>1.36. ZKKK - Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete;</p> <p>1.37. PKK - Pikat e Kalimit Kufitar;</p> <p>1.38. QPS - Qendrat për Punë Sociale;</p> <p>1.39. ZP - Zyrat e Punësimit.</p>	<p>1.28. MH - Ministry of Health;</p> <p>1.29. MTI - Ministry of Trade and Industry;</p> <p>1.30. MED - Ministry of Economic Development;</p> <p>1.31. NGO - Non Governmental Organization;</p> <p>1.32. IO - International Organization;</p> <p>1.33. SOP - Standard Operation Procedure;</p> <p>1.34. VTC - Vocational Training Centre;</p> <p>1.35. CMS - case management System;</p> <p>1.36. MORC - Municipal Office for return and Communities;</p> <p>1.37. BCP - Border Crossing Points;</p> <p>1.38. SWC - Social Work Centre;</p> <p>1.39. EO - Employment Offices</p>	<p>1.28. MZ - Ministarstvo Zdravlja;</p> <p>1.29. MTI - Ministarstvo Trgovine i Industrije;</p> <p>1.30. MER - Ministarstvo Ekonskog Razvoja;</p> <p>1.31. NO - Nevladina Organizacija;</p> <p>1.32. MO - Međunarodne Organizacije;</p> <p>1.33. SOP - Standardni Operativni Postupci;</p> <p>1.34. CSO - Centri za Stručno Osposobljavanje;</p> <p>1.35. SUS - Sistem za Upravljanje slučajevima;</p> <p>1.36. OKPZ - Opštinska Kancelarija za Povratak i Zajednice;</p> <p>1.37. TGP - Tačke graničnog prelaza;</p> <p>1.38. CSR - Centar za socialni rad;</p> <p>1.39. KZ - Kancelarija za zapošljavanje.</p>
---	--	--

<p>KAPITULLI II KRITERET E PËRGJITHSHME, MASAT PËR MBËSHTETJEN E RIINTEGRIMIT TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR DHE KRITERET SPECIFIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Kriteret e përgjithshme</p> <p>1. Për të përfituar nga programi për riintegrim, personat e riatdhesuar duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme si në vijim:</p> <p>1.1. Të kenë dorëzuar kërkesën për përfitim brenda afatit prej gjashtë (6) muaj nga data e riatdhesimit për përfitim të skemave emergjente, ndërsa brenda dymbdhjetë (12) muajve nga data e riatdhesimit për përfitim të skemave për riintegrim të qëndrueshëm;</p> <p>1.2. Të mos jenë të riatdhesuar për herë të dytë ose më shumë;</p> <p>1.3. Të mos ketë përfituar nga ndonjë skemë e ngjashme prej organizatave vendore ose ndërkombëtare;</p> <p>2. Personat e riatdhesuar mund të jenë përfitues të ndihmës dhe mbështetjes të</p>	<p>CHAPTER II GENERAL CRITERIA, MEASURES FOR SUPPORTING THE REINTEGRATION OF REPATRIATED PERSONS AND SPECIFIC CRITERIA</p> <p style="text-align: center;">Article 4 General criteria</p> <p>1. In order to benefit from the reintegration program, repatriated persons should fulfil the general criteria as follows:</p> <p>1.1. To have submitted the request for benefit within the period of six (6) months from the date of repatriation for benefiting of emergency schemes, whilst within twelve (12) months from the date of repatriation for benefiting of scemes for sustainable reintegration;</p> <p>1.2. To not be repatriated for the second time or more;</p> <p>1.3. To not have benefited from any similar scheme from local or international organizations;</p> <p>2. Repatriated persons can be beneficiaries of the program of assistance</p>	<p>POGLAVLJEII OPŠTE MERE, MERE ZA PODRŽAVANJE REINTEGRACIJE READMISANIH I POSEBNI KRITERIJUMI</p> <p style="text-align: center;">Član4 Opštikriterijumi</p> <p>1. Da imaju koristi od programa za reintegraciju vraćenih osoba će ispunjavaju opšte uslove:</p> <p>1.1. Je podneo zahtev za korist u roku od šest (6) meseci od dana readmisije za korist iz hitne šeme, dok u roku od dvanaest (12) meseci od dana readmisije za korist iz šema za održivu reintegraciju;</p> <p>1.2. Nije vraćen po drugi put ili više;</p> <p>1.3. Nije stekao pomoć iz slične šeme iz domaćih ili međunarodnih organizacija;</p> <p>2. Vraćene osobe mogu biti korisnici pomoći i podrške kako je definisano u</p>
--	---	---

<p>përcaktuara në nenet 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 21 të kësaj Rregullore, në qoftëse kanë lëshuar Kosovën para datës 28 korrik të vitit 2010.</p> <p>3. Përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, të drejtë përfitimi nga programi i riintegritit kanë personat me nevoja të veçanta siç është e përcaktuar në nenin 22 të kësaj Rregullore.</p> <p>4. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, barazia etnike, fetare, gjinore, racore, liria e lëvizjes dhe interesi më i mirë i fëmijëve, do të zbatohen gjatë procesit të riintegritit të personave të riatdhesuar.</p>	<p>and support set out in articles 8, 9, 10, 11, 12, 13 and 21 of this Regulation, if they have left Kosovo before the date of 28th July 2010.</p> <p>3. Exceptionally from paragraph 2 of this Article, the right to benefit from the reintegration program have the persons with special needs as defined in Article 22 of this Regulation.</p> <p>4. International Standards for Human Rights as well as ethnic, religious, gender, racial equality, freedom of movement and the best interest of the children shall be applied in the process of supporting the reintegration of repatriated persons.</p>	<p>članovima 8, 9, 10, 11, 12, 13 i 21 ove uredbe, ako napustili su Kosovo pre 28 Jula 2010 Godine.</p> <p>3. Izuzetak iz stava 2 ovog člana pravo na koristi od programa reintegracije imaju osobe sa posebnim potrebama kako je deifinisano u članu 22 ove uredbe.</p> <p>4. Međunarodni standardi za ljudska prava, etničke jednakosti, verske, polne, rasne, sloboda kretanja i najbolji interes dece biće realizovan tokom procesa reintegracije vraćenih osoba.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Masat për mbështetjen e riintegritit</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Measures for reintegration support</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Mere za podršku reintegracije</p>
<p>1. Riintegritimi i personave të riatdhesuar mbështetet nga përfitimet dhe ndihma si: ndihma menjëherë pas arritjes, përfitimet emergjente dhe masat që e mbështesin riintegritimin e qëndrueshëm.</p> <p>2. Ndihma dhe mbështetja nga programi iu sigurohet personave të riatdhesuar, parashtruesëve të kërkesave, pa diskriminim në bazë të origjinës, përkatësisë etnike, fetare, racore dhe gjinore apo mënyrës së riatdhesimit.</p>	<p>1. Reintegration of repatriated persons is supported by benefits and assistance as: assistance immediately after arrival, emergency benefits and measures supporting the sustainable reintegration.</p> <p>2. Assistance and support from the program shall be provided to repatriated, persons who have submitted an application, without discrimination on the basis of their origin, ethnicity, religion, race or gender, or the type of repatriation.</p>	<p>1. Reintegraciju vraćenih osoba se oslanja na korist i pomoć kao: neposredne pomoći po dolasku, hitne koristi i mere koje podržavaju održivu reintegraciju.</p> <p>2. Koristi i pomoć iz programa za se osiguruju za readmisane osobe: podnosiocima zahteva, bez diskriminacije na osnovu porekla, nacionalnost, religije ili pola.</p>

<p>3. Personat e cenusëshëm mund të kenë nevojë për masa të veçanta mbështetëse. Personat e cenusëshëm duhet të identifikohen dhe nevojat e tyre për përfitime dhe mbështetje vlerësohen nga organet kompetente.</p> <p>4. Nevojat e veçanta të personave të cenusëshëm dhe interesi më i mirë i fëmijëve, duhet të merren parasysh gjatë gjithë procesit.</p>	<p>3. Vulnerable persons may need special supportive measures. Vulnerable persons shall be identified and their needs for benefits and assistance shall be assessed by competent authorities.</p> <p>4. Special needs of vulnerable persons and the best interest of the children shall be considered during the whole process.</p>	<p>3. Ugrožene osobe mogu da imaju potrebe za posebne mere podrške. Ugrožene osobe trebalo bi da budu identifikovani, a njihove potrebe za podrškom i beneficije će biti ocenjeni od strane nadležnih organa.</p> <p>4. Posebne potrebe ugroženih lica i u najboljem interesu dece treba uzeti u obzir tokom procesa.</p>
<p>Neni 6 Informimi</p>	<p>Article 6 Information</p>	<p>Član 6 Informacije</p>
<p>1. Personave të riatdhesuar do t'iu ofrohen informata lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre, informata për ndihmën dhe përfitimet e tjera që sigurohen në pajtim me këtë Rregullore, si dhe informatat për shërbimet themelore në komunën e destinimit.</p> <p>2. Informatat duhet të sigurohen në gjuhët zyrtare të Kosovës, si dhe në gjuhët zyrtare në nivelin komunal.</p> <p>3. Informatat themelore do t'iu ofrohen personave të riatdhesuar menjëherë pas arritjes në Pikat e Kalimit Kufitar. Informatat lidhur me shërbimet komunale duhet t'iu jepen personave të riatdhesuar me</p>	<p>1. Repatriated persons shall be provided with the information about their rights and obligations, information on the assistance and other benefits provided according to this Regulation, as well as information on the basic services in the municipality of destination.</p> <p>2. Information shall be provided in official languages of Kosovo, as well as in languages in the municipal level.</p> <p>3. Basic information shall be provided to all repatriated persons immediately upon arrival at all Border Crossing Points. Information relating to municipal services shall be provided to repatriated persons</p>	<p>1. Vraćenim osobama se pruže informacije u pisanoj formi i usmeno o njihovim pravima i obavezama, informacije o pomoći i druge pogodnosti koje se pruža u skladu sa ovom uredbom, kao i informacije o osnovnim uslugama u opštini odredišta.</p> <p>2. Informacije treba da se obezbede na službenim jezicima Kosova, kao i službenih jezika u upotrebi na opštinskom nivou.</p> <p>3. Osnovne informacije koje će biti pružene osobama odmah po dolasku u graničnom prelazu. Informacije u vezi sa komunalnim uslugama treba da se pruže readmisiranim osobama odmah nakon dolaska u određenu</p>

<p>të arritur në komunën e destinimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Pritja e organizuar dhe ndihma pas arritjes</p> <p>1. Pritja e organizuar, informimi dhe ndihma mjekësore në rast nevojë ofrohet menjëherë pas arritjes në PKK.</p> <p>2. Ndihma mjekësore për personat e riatdhesuar sigurohet nga ekipet mjekësore menjëherë pas arritjes, nëse nevojat për këtë ndihmë i është komunikuar DRPR-së, nga shteti dërgues para arritjes. Në rast nevojë kujdesi mjekësor sigurohet edhe pa informim paraprak.</p> <p>3. Transporti nga pika e arritjes deri në komunën e destinimit do të sigurohet, nëse personi i riatdhesuar nuk ka mjete tjera transportuese që i mundësojnë personit ose familjes së tij të arrijë në vendin e destinacionit.</p>	<p>immediately upon arrival at the municipality of destination.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Organized reception and the assistance upon arrival</p> <p>1. The organized reception, information and medical assistance in case of need shall be provided immediately after arrival at BCP.</p> <p>2. Medical assistance for repatriated persons shall be provided by medical teams immediately after arrival, if the need for such assistance was communicated to DRRP by the sending country before the arrival. In case of need the medical care shall be provided even without previous information.</p> <p>3. Transportation from the point of arrival to the municipality of destination shall be provided if the repatriated person has no other transportation means that would enable the person or the family to go to the place of destination.</p>	<p>opštinu destinacije.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Organizovani doček i pomoć po dolasku</p> <p>1. Organizovani doček, informacije i medicinska pomoć u slučaju potrebe pružaju se odmah nakon dolaska u GP.</p> <p>2. Medicinsku pomoć za vraćena lica obezbeđuje medicinska ekipa odmah po dolasku, ako potreba za takvu pomoć je saopštena DRVO iz države pošiljaoca pre dolaska. Ako je potrebno, medicinska nega obezbeđuje se bez predhodnog obaveštenja.</p> <p>3. Prevoz od tačke dolaska do opštine destinacije će da bude obezbeđena ako readmisirana osoba nema druga prevozna sredstva koja omogućavaju osobu ili porodicu da stignu istog dana do odredišta.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Strehimi i përkohshëm</p> <p>1. Strehimi i përkohshëm në Qendrën e Akomodimit iu sigurohet personave të</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Temporarily accommodation</p> <p>1. Temporarily accommodation at the Accommodation Centre shall be provided</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Privremeno stanovanje</p> <p>1. Privremeno stanovanje u Centar za smeštaj se pružiti readmisiranim licama</p>

<p>riatdhesuar të cilët pas arritjes nuk kanë mundësi tjera akomodimi.</p> <p>2. Strehimi i përkohshëm ofrohet deri në shtatë (7) ditë ku ofrohen edhe shërbimet e tjera elementare dhe trajtim mjekësor sipas nevojës.</p>	<p>to repatriated persons if they have no other possibility for accommodation after arrival.</p> <p>2. Temporarily accommodation shall be provided up to seven (7) days, together with the provision of other basic services and the medical treatment as necessary.</p>	<p>ako nemaju drugi smeštaj na raspolaganju.</p> <p>2. Bonus za stanovanje će biti obezbeđen za period od sedam (7) dana i druge elementarne usluge i medicinska nega po potrebi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Përfitimet emergjente Banimit përmes qirasë</p> <p>1. Shpenzimet e banimit me qira mbulohen nga programi, nëse familjet e riatdhesuara nuk kanë mundësi tjera të banimit dhe për shkak të gjendjes së rëndë socio-ekonomike nuk mund të përballojnë shpenzimet e akomodimit.</p> <p>2. Shpenzimet për akomodim do të sigurohen për një periudhë gjashtë (6) muajore me mundësi vazhdimi edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë.</p> <p>3. Shpenzimet e qirasë përcaktohen sipas ofertës më të lirë të tregut në komunën përkatëse duke përfshirë dhe shpenzimet komunale.</p> <p>4. Çmimi i qirasë sipas paragrafit 3 të këtij neni, përcaktohet në vendimin e komisionit</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Emergency Benefits Housing through rent</p> <p>1. The rented housing expenses shall be covered by the program, if the repatriated families have no other housing possibilities and due to their difficult socio-economic conditions cannot afford the accommodation expenses themselves.</p> <p>2. Accommodation expenses shall be provided for a period of six (6) months with the possibility of extension for another six (6) months.</p> <p>3. The rent expenses shall be defined according to the lower price offer of the market in the respective municipality including the expenses of the public utility services.</p> <p>4. The price of rent under the paragraph 3 of this Article shall be determined in the</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Hitna korist Stanovanje pod kirijom</p> <p>1. Troškovi za stanovanje pod kirijom pokrivaju se od programa, ako vraćene porodice nemaju drugih opcija stambenih i zbog teških društvenih – ekonomskih uslova ne mogu da priušte troškove smestaja.</p> <p>2. Troškovi za smeštaj će biti obezbeđen za period od šest (6) mjeseci sa mogućnošću produženja za šest (6) drugih meseci.</p> <p>3. Troškovi zakupa određuju se na osnovu najjeftinije tržišne podnude u dotičnoj opštini uključujući komunalne troškove.</p> <p>4. Cena kirije u skladu sa stavom 3 ovog Člana, biće određena u rešenju opštinske</p>

<p>komunal.</p> <p>5. Me skadimin e afatit të fundit për akomodim, komuna përkatëse në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, është e obliguar të siguroj banim të qëndrueshëm për personin e riatdhesuar.</p>	<p>decision of the municipal commission.</p> <p>5. Upon expiration of the deadline for accommodation, the respective municipality in compliance to the Law on local self-government and the Law on financing of special housing programs shall be obliged to provide sustainable housing to the repatriated person.</p>	<p>komisije.</p> <p>5. Istekanjem roka za smeštaj, nadležna opština u skladu sa Zakonom o lokalnoj samoupravi i Zakon o finansiranju posebnih programa stanovanja obavezna je da osiguruje održivo stanovanje za readmisene osobe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Asistenca sociale</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Social Assistance</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Socijalna pomoć</p>
<p>1. Asistenca sociale iu sigurohet personave të riatdhesuar të cilët janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale, e për shkak të moshës apo gjendjes shëndetësore nuk janë në gjendje të sigurojnë mjete të nevojshme për jetesë.</p> <p>2. Asistenca sociale sigurohet nga Programi derisa personi i riatdhesuar të hyjë në skemat sociale në harmoni me legjislacionin në fuqi apo në tregun e punës.</p> <p>3. Vlera e asistencës sociale përcaktohet në harmoni me legjislacionin në fuqi për skemën e ndihmës sociale në Kosovë.</p> <p>4. Asistenca sociale sigurohet një (1) herë në muaj, në periudhën prej gjashtë (6) muajsh me mundësi vazhdimi edhe për</p>	<p>1. Social assistance is provided to the repatriated persons who, because of the difficult economic and social situation, or due to age, health condition are not able to provide themselves the necessary means for living.</p> <p>2. Social assistance is provided by the program until repatriated person will enter into social schemes in accordance with the legislation in force.</p> <p>3. The value of the social assistance is determined in accordance with legislation in force for the social assistance scheme in Kosovo.</p> <p>4. Social assistance shall be provided one (1) time per month, in a period of six (6) months with possibility of extension for</p>	<p>1. Socijalna pomoć obezbeđena je za repatrirane osobe koje su u teško ekonomsko i socijalno stanje, i zbog starosti ili zdravstvenog stanja nisu u mogućnosti da obezbede sredstva neophodna za život.</p> <p>2. Socijalna pomoć obezbeđuje se od Programa dok readmisana osoba ne uđe u socijalnim programima u skladu sa zakonom na snazi.</p> <p>3. Vrednost socijalne pomoći se određuje u skladu sa zakonom o programu socijalne pomoći na Kosovu.</p> <p>4. Socijalna pomoć se obezbedi jednom mesečno (1), tokom perioda od šest (6) meseci uz mogućnost produženja za šest (6)</p>

<p>gjashtë (6) muaj të tjerë.</p> <p>5. Personat e riatdhesuar të cilët në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm nuk mund të parashetrojnë kërkesë për përfitim nga asistencë sociale, mund të përfitojnë pako ushqimore, higjienike e materiale, deri në pajisjen me dokumente të nevojshme për përfitim nga kjo asistencë.</p> <p>6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me komunën përkatëse, duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, që brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore, t'i mundësojnë personave të riatdhesuar të përfitojnë nga skemat sociale, në harmoni me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Pako e ndihmës për dimër</p> <p>1. Pakon e ndihmës për dimër mund të përfitojnë personat e riatdhesuar të cilët për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe sociale nuk mund të sigurojnë vetë këtë pako.</p> <p>2. Përfitues të kësaj pako mund të jenë personat e riatdhesuar të cilët sipas kushteve të banimit kanë mundësi për shfrytëzimin e saj për ngrohje.</p> <p>3. Pako e ndihmës për dimër i'u</p>	<p>another six (6) months.</p> <p>5. Repatriated persons who due to the lack of necessary documentation could not apply for benefits from the Social assistance can benefit food, hygiene and material packages, until they will be provided with the necessary documents for benefiting from this assistance.</p> <p>6. Ministry of Labour and Social welfare in cooperation with the respective municipality shall take all necessary measures in the shortest possible time, to enable repatriated persons to benefit from social schemes in line with the legislation in power.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Winter assistance package</p> <p>1. Winter assistance package can benefit the repatriated persons who due to difficult economic and social conditions are not able to provide this package themselves.</p> <p>2. The beneficiaries of this package can be repatriated persons who according to the housing conditions are able to use it for heating.</p> <p>3. Winter assistance package is distributed</p>	<p>meseci.</p> <p>5. Vraçene osobe koje nemaju potrebnu dokumentaciju ne mogu da apliciraju za korist iz socijalne pomoći, mogu imati koristi paket materijala, da opremanja sa potrebnim dokumentima.</p> <p>6. Ministarstvo rada i socijalne zaštite u saradnji sa dotičnom opštinom, mora preduzeti sve neophodne mere da što u kraćem vremenskom periodu omogućavaju readmisanim osabama da imaju korist od socijalnih šemi, u skladu sa zakonom na snazi.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Paket pomoći za zimu</p> <p>1. Paket pomoći za zimu mogu imati koristvraćene osobe koje zbog teških ekonomskih i socijalnih uslova ne mogu da obezbede ovaj paket.</p> <p>2. Korisnici ovog paketa mogu biti vraćene osobe koje prema uslovima stanovanja imaju pristup njenog korišćenja za grejanje.</p> <p>3. Paket pomoći za zimu raspodeli se</p>
---	--	--

<p>shpërndahet personave apo familjeve të riatdhesuara, dimrin e parë pas riatdhesimit e cila ka vlerën 200 €.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Trajtimi mjekësor</p> <p>1. Personat e riatdhesuar mund të përfitojnë mbulimin e shpenzimeve nga Programi për trajtim mjekësor, trajtim psiko-social në rast nevoje, i cili nuk ofrohet nga institucionet publike, si dhe për mbulimin e shpenzimeve për barëra të cilat nuk gjenden në LEB.</p> <p>2. Kërkesës për trajtim mjekësor duhet t'i bashkëngjitet raporti i mjekut specialist dhe dokumentet përcjellëse nga Institucioni Shëndetësor Publik.</p> <p>3. Trajtimi mjekësor mund të sigurohet deri dymbëdhjetë (12) muaj nga data e riatdhesimit.</p>	<p>to repatriated persons or families, in the first winter after repatriation and has the value of 200 €.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Medical treatment</p> <p>1. Repatriated persons can benefit from the Program the coverage of expenses for medical treatment, psycho-social treatment according to the need, which is not provides by public institutions and the coverage of expenses for medicaments that are not found in LED.</p> <p>2. The request for medical treatment should have attached the report of specialist doctor and other related documents from the Public health institution.</p> <p>3. Medical treatment can be provided up to twelve (12) months from the date of repatriation.</p>	<p>licima ili porodicama vraćeni, prvu zimu nakon povratka koji u vrednosti od 200 evra €.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Medicinsko tretiranje</p> <p>1. Vraćene osobe mogu imati koristi od povrivanja troškova iz programa za lečenje, psihosocijalni tretman po potrebi, koja se ne nudi javnim institucijama, i pokrivanje troškova za lekove koji se ne nalaze u LEB.</p> <p>2. Zahtevu za medicinsku tretiranje treba da se priloži izveštaj specijalista i prateća dokumentacija iz javnih zdravstvenih ustanova.</p> <p>3. Medicinska pomoć može biti pružena u periodu od šest dvanaest(12) meseci od dana readmisije.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Pakoja e orendive</p> <p>1. Pakoja e orendive mund të sigurohet për personat e riatdhesuar nëse atyre iu mungojnë orenditë dhe kanë nevojë për këtë pako.</p> <p>2. Pakoja e orendive mund të sigurohet</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Furniture package</p> <p>1. A furniture package can be provided for repatriated persons if they lack furniture and need this package.</p> <p>2. The furniture package shall be provided</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Paket nameštaja</p> <p>1. Paket nameštaja može se obezbediti readmisenim licama, ako nemaju nameštaj i trebaju ovaj paket.</p> <p>2. Nameštaj paket može se obezbediti samo</p>

<p>vetëm një herë. Përmbajtja e pakos së orendive është e përcaktuar në shtojcën e kësaj rregulloreje.</p> <p>3. Vlera e përgjithshme e përfitimit për familje të riatdhesuara nuk mund të kalojë shumën prej 2000 €, për personat individual nuk mund të kalojë shumën 1000 €.</p> <p style="text-align: center;">Neni 14 Masat për mbështetjen e riintegritit të qëndrueshëm</p> <p>1. Masat për mbështetjen e riintegritit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar janë përcaktuar nga neni 15 deri në nenin 20 të kësaj Rregulloreje si në vijim: kurset e gjuhës dhe arsimimi i fëmijëve të riatdhesuar, aftësimi profesional, ndërmjetësimi për punësim dhe ndihma për vetëpunësim përmes financimit të projekteve për gjenerimin e të hyrave vetanake, banimi përmes renovimit/rindërtimit të shtëpive.</p> <p>2. Verifikimi i gjendjes civile, regjistrimi dhe dokumentacioni nga librat e gjendjes civile sigurohen nga komuna përkatëse për nevojat e personave të riatdhesuar në harmoni me legjislacionin në fuqi.</p> <p>3. Komunitet, po ashtu sigurojnë shërbimet</p>	<p>only one time. The content of the furniture package is determined in the Annex of this Regulation.</p> <p>3. The total amount of the benefit for a repatriated family shall not exceed the amount of 2000 €, For individual persons shall not exceed the amount of 1000 €.</p> <p style="text-align: center;">Article 14 Measures for supporting the sustainable reintegration</p> <p>1. Measures to support the reintegration of repatriated persons are defined in Articles 15 to 20 of this Regulation as follows: language courses and education of repatriated children, vocational training, mediation for employment and assistance for self-employment through projects for generating of their own income, housing through renovation/reconstruction of houses.</p> <p>2. Civil status verification, registration and documentation form the Civil Status Registry shall be provided by the respective municipality for the needs of repatriated persons in line with the legislation in power.</p> <p>3. The municipalities shall also provide</p>	<p>jednom. Paketa nameštaja je određena u Aneksu ove uredbe.</p> <p>3. Ukupna vrednost koristi za porodicu readmisenih ne treba da prelazi iznos od 2000 €. Vrednost za pojedinačne osobe ne sme da prelazi ukupan iznos od 1000 € .</p> <p style="text-align: center;">Član 14 Mere za podršku održive reintegracije</p> <p>1. Održive mere za podršku reintegracije readmisiranih lica su definisane u članu 15 do člana 20 ovog pravilnika i to: stanovanje u renoviranim stambenim objektima/rekonstrukcija stambenih objekata, kursevima jezika i obrazovanje readmisirane dece, profesionalno osposobljavanje, posredovanje i pomoć za samozapošljavanje finansiranjem kroz projekta za generisanje prihoda, stanovanje sa renoviranjem/izgradnjem kuća.</p> <p>2. Verifikacija civilne registracije i dokumentacije državnih knjiga, koju daju opštinama za potrebe readmisiranih lica u skladu sa zakonodavstvom na snagu.</p> <p>3. Opštine takođe prema relevantnim</p>
---	---	---

<p>themelore komunale siç janë: këshillimi, regjistrimi civil, banimi, arsimimi, mirëqenia sociale, punësimi, kujdesi shëndetësor dhe trajtimi mjekësor për personat e riatdhesuar në bazë të legjislacionit përkatës.</p> <p>4. Shërbimet duhet të ofrohen në bazë të vlerësimit të nevojave nga komunat në mënyrë që të mbështetet riintegrimi social dhe ekonomik i personave të riatdhesuar.</p> <p>5. Personave të riatdhesuar iu sigurohen informatat e duhura, udhëzimet dhe këshillat lidhur me shërbimet dhe masat e tjera të komunës në pajtim me nenin 6 të kësaj Rregulloreje.</p>	<p>basic municipal services such as: counselling, civil registration, housing, education, social welfare, employment, health care and medical treatment for repatriated persons according to the respective legislation.</p> <p>4. Services shall be provided based on the needs assessment by the municipalities in order to support the social and economic reintegration of repatriated persons.</p> <p>5. The repatriated persons shall be provided with appropriate information, guidance and advice concerning services and other measures of the municipality in accordance with Article 6 of this Regulation.</p>	<p>propisima pružaju osnovne komunalne usluge kao što su savetovanje, civilne registracije, stanovanje, obrazovanje, socijalnu zaštitu, zapošljavanje, zdravstvenu zaštitu i medicinski tretman za readmisene osobe.</p> <p>4. Usluge treba da se obezbeduju na osnovu procene potreba od strane opština kako bi se podržalo socijalna i ekonomska reintegracija vraćenih lica.</p> <p>5. Vraćene osobe dobijaju odgovarajuće informacije, instrukcije i savete o uslugama i drugim opštinskim merama u skladu sa članom 6. ove uredbe.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15 Arsimimi për fëmijët</p>	<p style="text-align: center;">Article 15 Education for children</p>	<p style="text-align: center;">Član 15 Obrazovanje za decu</p>
<p>1. Të gjithë fëmijët e riatdhesuar kanë të drejtë të vijojnë shkollimin në shkolla adekuate në Kosovë. Fëmijët e riatdhesuar gëzojnë të drejta të barabarta me fëmijët e tjerë në shkollat e Kosovës. Vëmendje e veçantë i kushtohet fëmijëve me nevoja të veçanta. Komuna përkatëse përmes Drejtorisë Komunale për Arsim (DKA) përkujdeset për regjistrim në shkolla për fëmijët e riatdhesuar.</p>	<p>1. All repatriated children, shall be entitled to attend education in adequate schools in Kosovo. Repatriated children enjoy equal rights with other children in schools in Kosovo. Special attention shall be paid to the children with special needs. The respective municipality through the Municipal Education Directorate (MED) shall take care for registration of repatriated children in schools.</p>	<p>1. Sva deca imaju pravo da pohađaju odgovarajuće škole na Kosovu. Vraćena deca imaju jednaka prava sa ostalom decom u školama na Kosovu. Posebna pažnja posvećena je deci sa posebnim potrebama. Dotična opština preko Opštinske direkcije za obrazovane (ODO) stara se za upis vraćenih deca.</p>

<p>2. Komuna në rast nevoje do të ofroj kurse të gjuhës dhe mësim plotësues për fëmijet e riatdhesuar.</p> <p>3. Para regjistrimit në kurse të gjuhës, bëhet vlerësimi individual i njohurive të gjuhës që mësohet në shkollë, në mënyrë që të përcaktohet shkalla e njohurive të gjuhës në të cilën mësohet në gjuhën e tij.</p> <p>4. Fëmijët e riatdhesuar duhet të kenë qasje në shkollë në nivelin e duhur të arsimimit përfshirë edhe edukimin parashkollor.</p> <p>5. Qasja në shkolla bëhet menjëherë pas riatdhesimit dhe ndërkohë duhet të sigurohen dhe të dorëzohen në shkollën përkatëse dokumente konkrete të cilat e dëshmojnë nivelin e arsimimit.</p>	<p>2. The municipality, in case of need, shall provide language courses and catch-up classes for repatriated children.</p> <p>3. Before the registration of children for language courses an individual evaluation of the language knowledge taught at school shall be done in order to ascertain the level of their language skills.</p> <p>4. Repatriated children shall have access to school at their appropriate level of education including also the pre-school education.</p> <p>5. Access to school takes place immediately after repatriation, and in meantime the concrete documents which prove their respective level of education shall be provided and submitted to the respective school.</p>	<p>2. Opština u slučaju potrebe će obezbediti kurseve jezika I dodatnu nastavu za decu vraćeni.</p> <p>3. Pre upisa na kurseve za jezike vrši se individualno ocenjivanje znanja jezika koji se uči u školi u namerom za procenom stepena znanja jezika na kojem se uči.</p> <p>4. Vraćene dece treba da imaju pristup u školi u njihovom nivom obrazovanja uključujući I predškolsko obrazovanje.</p> <p>5. U međuvremenu treba da se obezbede i da se dostavljaju u školi određene dokumente koji pokazuju nivo obrazovanja.</p>
